



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi

VENDIM

Nr. 5, Datë 10.01.2018

MBI

**SHTYRJEN E AFATIT PËR REALIZIMIN E KUSHTEVE TË VENDOSURA NGA ERE SHOQËRISË, “ALB WIND ENERGY” MBAJTËSE E LICENCËS NR. 53, SERIA NPM08P, “PËR NDËRTIMIN, INSTALIMIN, SHFRYTËZIMIN DHE PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALE EOLIKE”**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 42, gërma “a” të Ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë të Elektrike”; neni 11 gërma “a”; neni 104 pika 4 gërma “a” neni 113 pika 1 dhe 3, neni 116 pika 1 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative, neni 9 gërma “a”, të “Rregullore për Procedurat e Heqjes së një Licence,” Bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 10.01.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, mbi shtyrjen e afatit të ndërtimit të centraleve elektrike me erë (Projekti VISU me fuqi 140 MW dhe projekti TERPAN me fuqi 85 MW), për shoqërinë “Alb Wind Energy“ sh.p.k,

**Konstatohet se:**

- Bordi i ERE me vendimin nr. 13, datë 28.01.2008, ka licencuar shoqërinë “Alb Wind Energy” sh.p.k në aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike me erë, si dhe prodhimin e energjisë elektrike për projektet VISU me fuqi 140 MW, dhe projekti TERPAN me fuqi 85 MW.
- ERE ka miratuar shtyrjen e afateve të ndërtimit të parkut eolik me vendimet :
  - Vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 68, datë 13.09.2010,
  - Vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 139, datë 15.11.2013.
- Bordi i ERE me vendimin nr. 89 datë 09.06.2016, ka vendosur :
  - Rrëzimin e kërkesës së shoqërisë “ALB WIND ENERGY” sh.p.k, për zgjatjen e afatit të Ndërtim, Instalim, Shfrytëzimit të Centrale Elektrike dhe prodhimin e energjisë elektrike nga Parku Eolik “Projekti VISU dhe projekti TERPAN”

- Fillimin e procedurave për heqjen e licencës së shoqërisë “Alb Wind Energy“ sh.p.k, nr. 53, Seria NPM08P dhënë me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 13, datë 28.01.2008.
- ERE i është drejtuar Ministrisë përgjegjëse për energjinë me shkresën nr 736 prot, datë 27.12.2017 në mbështetje të nenit 10 pika 2 të ligjit 43/2015 “Për Sektorin e energjisë elektrike” me kërkesën për informacion dhe qëndrimin e insitucionit politikbërës të sektorit të energjisë.
- ERE me Urdhërin nr. 67, datë 17.11.2016 dhe Urdhërin nr. 17, datë 04.04.2017, ka ngritur grupe pune dhe ka kryer dy monitorime pranë kësaj shoqërie për të kontrolluar dhe konstatuar ecurinë e punimeve dhe nivelin e investimit.
- Nga monitorimi dhe deklaratimet e subjektit është konstatuar, se ka patur vonesa në etapat administrative, dokumentacionin e kërkuar për vijimin e punës, rihapjen, përmirsimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve të antenave matese, grumbullimin e të dhënave të parametrave të shpejtësisë së erës për plotësimin përfundimtar të studimit të fizibilitetit etj.
- Për zhvillimin e projektit janë bërë investime serioze financiare, dhe vonesat në realizimin e projektit janë shkaktuar përtej vullnetit të aplikuesit i cili rezulton se ka bërë çdo përpjekje të arsyeshme për të përmbushur qëllimin.
- Së fundmi, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë me shkresën nr. 2018/1Prot, datë 26.12.2017, protokolluar me tonën nr. 736/1 Prot, datë 27.12.2017, sqaron mes të tjerave se : *duhet të merren masa që shtyrja e afatit të ndërtimit të këtyre aplikimeve të bëhet vetëm në rast provueshmërie për arsyet objektive që nuk kanë lejuar realizimin e projekteve brenda afatit të tyre, me qëllim që në vijim të bëhet i mundur vleresimi dhe prioritizimi i tyre në përputhje me dispozitat e VKM 822, datë 7.10.2015 "Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, e nuk janë objekt koncesioni", i ndryshuar.*
- Në zbatim të rekomandimeve të institucionit politikbërës, konstatimeve të grupit të monitorimit, dokumentave të depozituara në ERE nga shoqëria, rezulton së ka arsye objektive që nuk kanë lejuar realizimin e projektit brenda afatit.

Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Shfuqizimin e Pikës 1 të Vendimit nr. 89, datë 09.06.2016 të Bordit të ERE “Mbi kërkesën e shoqërisë Alb Wind energy shpk, për shtyrjen e afateve të licensës nr. 53, seria NPM08P, për ndërtim, instalim, shfrytëzimin dhe prodhimin e energjisë elektrike

nga centrale eolike (projekti Visu dhe projekti Terpan)”, të dhënë me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s me nr. 13, datë 28.01.2008, i ndryshuar”.

2. Të mbyllë procedurën e nisur me vendimin nr. 89 datë 09.06.2016 të Bordit të ERE, për heqjen e licencës nr. 53, Seria NPM08P, “Për ndërtimin, instalimin, shfrytëzimin dhe prodhimin e energjise elektrike nga centrale eolike.
3. Shtyrjen e afatit për realizimin e kushteve të vendosura nga ERE në pikat 1, 2, 3 dhe 4 të vendimit nr. 13, datë 28.01.2008, Për dhënien e licencës për ndërtim, instalim dhe shfrytëzim të centraleve elektrik me erë si dhe prodhimin e energjisë elektrike nga këto centrale, shoqërisë “Alb Wind Energy” sh.p.k për projektet Visu dhe Terpan”, ndryshuar, mbajtëse e licencës nr. 53, Seria NPM08P, “Për ndërtimin, instalimin, shfrytëzimin dhe prodhimin e energjisë elektrike nga centrale eolike”, deri në datën 15.11.2019.
4. Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin dhe Ministrinë e Infrastruktës dhe Energjisë për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Petrit AHMETI**